

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7035
E martë, 31 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Specialja bastis shtëpitë e ish-këshilltarëve të Thaçit, reagojnë KMDLNj-ja dhe OVLUÇK-ja | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (6) | FAQE 4-5

VRASJET E DYFISHTA TË INTELEKTUALËVE SHQIPTARË



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së gjashtë ka folur për vrasjet e dyfishta të intelektualëve shqiptarë. Ai ka

thënë se Shtabi Strategjik i Millosheviqit kishte vendosur që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të ndërmerre sulme terroriste kundër civilëve serbë, shqiptarë dhe të përkatësive të tjera etnike, të cilat duhej t'i visheshin UÇK-së. "Jam plotësisht i vetëdijshëm

se edhe sot e kësaj dite bashkëpunëtorët e Serbisë, dhe pjella e tyre, vazhdojnë t'i zbatojnë udhëzimet e Shtabi Strategjik të Millosheviqit dhe për këto krime ta fajësojnë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës!", ka theksuar Bardhyl Mahmuti

AKTUALE



AVOKATI I VESELIT DHE I THAÇIT KUNDËRSHTOJNË DOKUMENTET E PARAQITURA NË SPECIAL F. 6

IZRAELI THELLON SULMIN USHTARAK NË VERI TË RRIPI TË GAZËS F. 2

HAXHIU: PARTNERITETI YNË ME BE-NË MBETET MJAFT I RËNDËSISHËM PËR ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TONA REFORMUESE F. 3

EKONOMI



NJË METËR DRU 65 EURO F. 8

PUNËTORËT FIZIKË TË KEK-ut MË 13 NËNTOR HYJNË NË GREVË F. 8

SPORT



KOSOVA SYNON FITORE NDAJ MAQEDONISË SË VERIUT F. 10

VON DER LEYEN: KOSOVA TA NISË ZBATIMIN E ASOCIACIONIT, SERBIA TA PRANOJË NJOHJEN DE-FACTO



Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet t'i normalizojnë marrëdhëniet. Pas takimit me presidenten e Kosovës, Vjosa

Osmani, në Prishtinë, Von der Leyen ka thënë se do të ketë hapa të suksesshëm përpara vetëm nëse Kosova dhe Serbia do t'i normalizojnë marrëdhëniet. Ajo përsëriti kërkesën e kancelarit të

Gjermanisë, Olaf Scholz, presidentit të Francës, Emmanuel Macron dhe të kryeministres së Italisë, Giorgia Meloni, për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli thellon sulmin ushtarak në veri të Rripit të Gazës



JERUSALEM, 30 TETOR - Trupat izraelite dhe autobлиндat kanë hyrë më thellë në veri të Rripit të Gazës më 30 tetor, duke arritur në zonat e banuara. Ndërkaq, Kombet e Bashkuara dhe stafi shëndetësor kanë paralajmëruar se sulmet ajrore po godasin më afër spitaleve, ku dhjetëra mijëra palestinezë janë strehuar dhe po trajtohen mijëra të plagosur. Intensifikimi i operacioneve tokësore u bë një ditë pasi 33 kamionë me ushqim, ilaçe dhe furnizime të tjera hynë në Gazë nga Egjipti.

Kjo është ndihma më e madhe humanitare që është dërguar në Rripin e Gazës qëkur ka nisur lufta ndërmjet Izraelit dhe militantëve palestinezë të Hamasit. Por, punëtorët e ndihmës thanë të hënën se, megjithatë, ndihma nuk është e mjaftueshme për nevojat në Gazë, që është nën rrethim për javë të tëra.

Ministria e Shëndetësisë në Gazë tha se numri i palestinezëve të

vrarë ka kaluar shifrën prej 8 000. Kjo ministri tha se shumica e viktimave janë gra dhe të mitur. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu paralajmëroi se ka nisur "faza e dytë" e luftës, pasi Hamasi nisi sulmet ndaj Izraelit më 7 tetor, duke vrarë më shumë se 1 400 persona, shumica civilë. Në një video të publikuar të hënën nga ushtria izraelite shiheshin autobлиндat duke lëvizur në mesin e ndërtesave në veri të Gazës dhe ushtarët duke u vendosur në pozicione brenda një shtëpie. Lokacioni i saktë se ku është incizuar videoja nuk dihet, por pamjet e publikuara të shtunën nga ushtria tregonin trupat duke ecur nëpër zona të zbratura afër kufirit në veri të Gazës.

Ushtria izraelite tha të hënën se gjatë natës trupat e saj kanë vrarë dhjetëra militantë që sulmuan nga brendësia e ndërtesave dhe tuneleve, duke shtuar se sulmet ajrore kanë shkatërruar një ndërtesë që po e

përdorte Hamasit. Po ashtu, ushtria tha se në ditët e fundit ka shënjestruar mbi 600 caqe militante, përfshirë depo të armëve dhe pozicione të raketahedhësve.

Këto pretendime nuk kanë mundur të konfirmohen në mënyrë të pavarur.

Krahu ushtarak i Hamasit tha se militantët janë përlëshur me armë të vogla dhe raketa kundërtanke me trupat izraelite që hynë në veriperëndim të Rripit të Gazës. Militantët palestinezë kanë vazhduar të hedhin raketa në Izrael, përfshirë një drejt Tel Avivit.

Linjat e komunikimit janë rikthyer për shumicën e 2.3 milionë banorëve të Gazës të dielën, pasi për më shumë se një ditë ata mbetën pa shërbime të telekomunikacionit dhe internetit, pas bombardimeve të ashpra.

Izraeli tha se shumica e banorëve të Gazës i janë bindur urdhrat të tij për t'u larguar në

pjesën jugore të territorit të rrethuar, por qindra mijëra vazhdojnë të jenë në veri, pjesërisht për shkak se Izraeli po sulmon në zonat e ashtuquajtura të sigurta.

Më shumë se 1.4 milion persona në Gazë janë larguar nga shtëpitë e tyre qëkur ka nisur lufta.

Rrethimi i Gazës nga Izraeli ka bërë që infrastruktura në këtë territor të jetë buzë kolapsit. Për javë të tëra, Rripi i Gazës nuk ka energji elektrike dhe spitalet po kanë vështirësi të operojnë, duke përdorur gjeneratorë për t'i mbajtur në punë inkubatorët dhe pajisjet kryesore.

Kombet e Bashkuara thanë, po ashtu, se në Rripin e Gazës nuk ka furnizime të mjaftueshme me ujë.

ShBA-ja i ka kërkuar Izraelit që menjëherë ta rrisë hyrjen e ndihmave humanitare për banorët në Gazë dhe Izraeli ka thënë se shumë shpejt do të lejojë që në territor të hyjë më

shumë ndihmë, pa specifikuar se sa.

Elad Goren, kreu i çështjeve civile në COGAT - trup i mbrojtjes izraelite që është përgjegjës për çështjet e civilëve palestinezë - tha se Izraeli ka hapur dy linja të ujit në jugun e Gazës. Këto pretendime nuk kanë mundur të konfirmohen në mënyrë të pavarur.

Ndërkaq, është rritur rreziku për spitalet e stërmbushura në veri të Gazës. Kombet e Bashkuara thanë më 30 tetor se ka pasur sulme afër spitalit Shifa në qytetin e Gazës dhe Al-Kuds në veri të Gazës. Të dhjetë spitalet që ende po punojnë në veri të Gazës kanë marrë urdhër për evakuim ditët e fundit, tha OKB-ja. Sipas OKB-së, përveç pacientëve dhe stafit, afër 117 000 persona të zhvendosur janë në këto spitale.

Banorët kanë raportuar të dielën për sulme ajrore afër spitalit Shifa, që është spitali më i madh në Rripin e Gazës. Izraeli akuzoi Hamasin se ka një qendër komanduese poshtë spitalit, por nuk dha dëshmi për këtë pretendim. Hamasi i mohoi këto akuza.

Sulmet ajrore kanë goditur 50 metra larg spitalit Al-Kuds, pasi autoritetet e spitalit të dielën pranuan dy thirrje nga autoritetet izraelite për evakuim, tha Gjysmehëna e Kuqe palestineze. Sipas kësaj organizate, 14 000 persona po strehohen në këtë spital.

Ndërkaq, luftimet midis Izraelit dhe Hamasit kanë rritur shqetësimet se konflikti mund të përhapet në rajon. Izraeli dhe grupi militant Hezbollah në Liban janë përlëshur për gjatë kufirit verior izraelit.

Po të hënën ushtria izraelite tha se avionët e saj kanë sulmuar infrastrukturën ushtarake në Siri pasi nga ajo pjesë janë hedhur raketa në territorin e Izraelit.

Afër 250 000 izraelitë janë evakuuar nga shtëpitë e tyre për shkak të dhunës përgjatë kufirit me Gazën dhe në kufirin verior me Libanin, ka thënë ushtria izraelite.

Ukraina thotë se ka rrëzuar 12 dronë të Rosisë

KIEV, 30 TETOR - Trupat ruse kanë kryer sulme të reja të dielën në mbrëmje ndaj Ukrainës, duke përdorur 12 dronë sulmues të llojit Shahed, njoftoi Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase më 30 tetor.

Ushtria tha se të gjithë dronët "janë shkatërruar nga sistemet e mbrojtjes kundërajrore".

Ushtria ukrainase tha se në 24

orët paraprake janë zhvilluar afër 60 beteja në vijat e frontit në Kupjansk, Limansk, Avdijivka, Marinsk, Shahtarsk dhe Zaporizhja. "Si rezultat i sulmeve, fatkeqësisht, ka të vdekur dhe të plagosur në mesin e civilëve", u tha në njoftimin e Shtabit të Përgjithshëm.

Sipas Ukrainës, Rusia ka sulmuar ndërtesa dhe

infrastrukturë civile të cilat janë shkatërruar ose dëmtuar.

"Në drejtim të Bahmutit [në lindje të Ukrainës], armiku pa sukses tentoi t'i rimerrte pozicionet e humbura afër Andrijivkës. Forcat ukrainase vazhduan operacionet e tyre sulmuese në jug të Bahmutit, duke i shkaktuar humbje në njerëz dhe pajisje armikut", shtoi ushtria ukrainase.



Von der Leyen: Kosova ta nisë zbatimin e Asociacionit, Serbia ta pranojë njohjen de-facto

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet t'i normalizojnë marrëdhëniet. Pas takimit me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në Prishtinë, Von der Leyen ka thënë se do të ketë hapa të suksesshëm përpara vetëm nëse Kosova dhe Serbia do t'i normalizojnë marrëdhëniet. Ajo përsëriti kërkesën e kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz, presidentit të Francës, Emmanuel Macron dhe të kryeministres së Italisë, Giorgia Meloni, për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka ripërsëritur sërish se dënojnë ashpër sulmin e dhunshëm të 24 shtatorit që ndodhi në Banjë të Zveçanit. Pas takimit me presidenten Vjosa Osmani në Prishtinë, Von der Leyen në një konferencë për medie të hënën ka thënë se kryerësit duhet të sillen para drejtësisë. “Ne fuqishëm dënojmë sulmet e dhunshme të 24 shtatorit dhe shpreh ngushëllimet për familjet, miqtë dhe kolegët e policit të vrarë. Një sulm i tillë është tërësisht i papranueshëm dhe kryerësit duhet të sillen para

drejtësisë”, ka thënë Von der Leyen. Presidentja e Komisionit Evropian më tej shtoi se BE-ja është shumë e zotuar për të ardhmen e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ajo foli edhe për procesin e liberalizimit të vizave, ku u shpreh se është një momentum i ri në raportin BE - Kosovë. “Më kujtohet viti i kaluar që të dyja ne bëmë thirrje për liberalizim të vizave, dhe tani mund të them se ia dolëm. Që nga 1 janari kosovarët mund ta gëzojnë lëvizjen e lirë. Kjo është një mënyrë fantastike për t'i afruar njerëzit”, u shpreh Von der Leyen. Ajo u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të punojnë për normalizimin e marrëdhënieve. “Ftojme edhe Kosovën ta nisë procedurën për zbatimin e

Asociacionit, kurse Serbia duhet ta pranojë njohjen de-facto. Kjo është mënyra e vetme për të shkuar përpara”, ka thënë presidentja e KE-së.

Von der Leyen, e cila shtoi se, përveç përafritimit të njerëzve, duhet t'i përafrojmë edhe ekonomitë tona. “Ne kemi planin 30 miliardësh investimesh për Ballkanin Perëndimor”, ka theksuar Von der Leyen.

“Qytetarët e Kosovës nga 1 janari udhëtojnë pa viza”

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, para medieve ka thënë se në takim me Von der Leyen kanë

biseduar për planin e BE-së për rritjen e Ballkanit Perëndimor dhe zhvillimet e fundit në Kosovë. “Takimi ynë u fokusua në planin për rritjen e Ballkanit Perëndimor, të cilin e prezantoi presidentja. Krahas kësaj, kisha mundësinë ta informoj Ursula von der Leyen për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe për angazhimet tona”, ka thënë ajo.

Osmani tha se plani për zgjerimin e Ballkanit Perëndimor bazohet në katër shtylla.

“Plani gjithëpërfshirës i bazuar në katër shtylla shënon një hap të rëndësishëm drejt integritetit tonë në tregun e përbashkët evropian. Ky plan parasheh mbështetjen e BE-së përmes rritjes së asistencës financiare për reformat që duhen

ndërmarrë. Në takim shpreha falënderimin që i dhanë epilog procesit të vizave, ku nga janari qytetarët do ta kenë mundësinë ta shfrytëzojnë lëvizjen e lirë në zonën Shengen”, u shpreh presidentja.

Osmani ka theksuar se Kosova ka qëllim anëtarësimin në BE dhe NATO, derisa ka kërkuar mbështetjen e Ursula von der Leyenit për procesin.

“Kërkova, po ashtu, të largohen masat ndëshkuese nga BE-ja”, ka thënë Osmani.

Presidentja, po ashtu, njoftoi se në takim ka folur edhe për sulmet terroriste të Serbisë ndaj Kosovës.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, ka takuar edhe kryeministrin Albin Kurti.

Para vizitës në Kosovë, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka qëndruar në Maqedoninë e Veriut. Ajo i ka porositur zyrtarët maqedonas se procesi i anëtarësimin të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian varet nga ndryshimet kushtetuese.

Pas takimit me kryeministrin maqedonas Dimitar Kovačevski, të hënën në Shkup, shefja e KE-së tha se ndodhet në Maqedoninë e Veriut që Kovačevskit dhe qytetarëve të këtij shteti t'ua përcjell mesazhin se “jeni në rrugë të mirë që t'i bashkoheni BE-së dhe se BE-ja mezi pret që t'ju shohë në mesin e saj”. “Ndryshimet kushtetuese janë një hap i domosdoshëm në rrugën drejt anëtarësimin në BE. Ajo çfarë ka arritur Maqedonia e Veriut është mbresëlënëse, andaj vërtet dëshiroj që Maqedonia e Veriut të vazhdojë të lëvizë përpara me vendosmëri në rrugën drejt anëtarësimin në BE”, ka pohuar von der Leyen, duke shtuar se dritarja e mundësive është e hapur dhe shpreson se të gjitha partitë do ta shfrytëzojnë çastin që të ecin përpara në miratimin e vendimeve të vështira, por që do të jenë për të mirën e Maqedonisë së Veriut.

Haxhiu: Partneriteti ynë me BE-në mbetet mjaft i rëndësishëm për arritjen e objektivave tona reformuese

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka marrë pjesë në takimin e dymbëdhjetë të Komitetit Drejtues të Programit të BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë - EUKOJUST. Ajo i ka falënderuar përfaqësuesit e BE-së dhe EUKOJUST për bashkëpunimin e dobishëm trevjeçar dhe për

mbështetjen e tyre në reformimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe të tërë sistemit të drejtësisë për këto vjet. “Në veçanti programi i EUKOJUST luajti një rol të rëndësishëm për mbështetjen profesionale në disa prej nismave tona të rëndësishme reformuese në fushën civile dhe penale, por

edhe në atë administrative. Rrugëtimi ynë reformues do të vazhdojë tutje dhe partneriteti ynë me BE-në dhe programet përkatëse mbetet mjaft i rëndësishëm për arritjen e objektivave tona reformuese për qasje më të lehtë në drejtësi, llogaridhënie dhe transparencë në sistem”, ka theksuar Haxhiu.





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (6)

Vrasjet e dyfishta të intelektualëve shqiptarë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së gjashtë ka folur për vrasjet e dyfishta të intelektualëve shqiptarë. Ai ka thënë se Shtabi Strategjik i Millosheviqit kishte vendosur që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të ndërmerre sulme terroriste kundër civilëve serbë, shqiptarë dhe të përkatësive të tjera etnike, të cilat duhej t’i visheshin UÇK-së. “Jam plotësisht i vetëdijshëm se edhe sot e kësaj dite bashkëpunëtorët e Serbisë, dhe pjella e tyre, vazhdojnë t’i zbatojnë udhëzimet e Shtabi Strategjik të Millosheviqit dhe për këto krime ta fajësojnë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës!”, ka theksuar Bardhyl Mahmuti

Prishtinë, 30 tetor -
“Epoka e re”: Në listat e sajuar nga Shërbimi Sekret i Serbisë janë përfshirë edhe emrat e një numri të konsiderueshëm personalitetesh të skenës politike dhe intelektuale të Kosovës që dihet botërisht se janë vrarë me urdhër të kreut të shtetit serb. Cilat raste do t’i veçonit për lexuesin?

Bardhyl Mahmuti: Po filloj me rastin e vrasjes së Fehmi Aganit, sepse është domethënëse për shumë aspekte. Për lexuesit që kanë lindur pas çlirimit të vendit dhe që eventualisht nuk e dinë se për kë bëhet fjalë, po përmend se Fehmi Agani ishte profesor i Universitetit të Prishtinës dhe një nga sociologët më të shquar që ka

pasur Kosova. Pas braktisjes së sistemit njëpartiak në Jugosllavi, ai, së bashku me Ibrahim Rugovën, u angazhua për themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe që nga themelimi i saj ishte nënkryetar i kësaj partie politike. Krahas angazhimeve në skenën politike të Kosovës, ai u shqua edhe për mbrojtjen e interesave të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Kam pasur fatin ta takoj gjatë aktiviteteve diplomatike që kemi zhvilluar si delegacion i Kosovës në institucionet e Bashkimit Evropian që u përmendën më herët. Përveç kësaj, vlen të theksohet se që nga negociatat e para që u zhvilluan në

fillim të viteve nëntëdhjetë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të gjetur një zgjidhje politike, e deri në Konferencën e Rambujesë, Fehmi Agani përfaqësoi delegacionin shqiptar të Kosovës. Më 6 maj 1999, në prani të familjarëve të tij dhe shumë qytetarëve të tjerë, Fehmi Agani u arrestua nga policia serbe. Me qëllim që kjo vrasje të mos paraqitej si vrasje e përgatitur nga strukturat e larta shtetërore, menjëherë pas vrasjes së Fehmi Aganit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, që ende kontrollohej nga regjimi i Millosheviqit, ngriti kallëzim penal kundër policëve serbë Predrag Nikoli (Nikolloq) dhe Zoran Dzeletovi (Xhelletoviq).

Ndriçimi i këtij rasti iu besua gjykatësës hetuese serbe Danica Marinkovi (Marinkoviq), e njohur si hetuese besnike e regjimit.

“Epoka e re”: Më falni për ndërhyrjen. Në veprën tuaj “Mashtrimi i madh”, hetuesja Danica Marinkoviq zë një vend tepër të rëndësishëm në kurdisjen e procesit gjyqësor kundër vëllezërve Mazreku për vrasjen e civilëve në Kleçkë, vrasje që duhej t’i visheshin UÇK-së; është personi të cilit iu besua hetimi për të “ndriçuar” se në fshatin Reçak “nuk ishin vrarë civilë shqiptarë” por, gjoja, “ushtarë të UÇK-së” e kështu me radhë.

Bardhyl Mahmuti: Danica Marinkovi ishte hetuesja më e besueshme e Sllobodan Millosheviqit në Kosovë. Meqenëse bëme një shmangie të vogël nga rasti i Fehmi Aganit, shmangie që ndihmon të kuptohet edhe më mirë logjika e funksionimit të regjimit të Sllobodan Millosheviqit, po rikujtoj se Danica Marinkovi ishte e përfshirë edhe në rastin e aktit gjenocidal në fshatin Likoshan. Për ta ilustruar këtë rast, po i

referohem një shkrimi të humanistes serbe Nataša Kandi (Natasha Kandi). Në artikullin “E vërteta shqetësuese” (Uznemiravajuca istina), të botuar në mars të vitit 2002, autorja shpalo dëshmitë e pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Policisë së Serbisë: “Nga policë që kanë qenë pjesëmarrës në vrasjet në fshatin Likoshan, më 28 shkurt 1998. kam mësuar se Danica Marinkovi kishte urdhëruar likuidimin e disa meshkujve të plagosur të familjes Ahmeti, Në shikimin e vendit të krimit kishte ardhur e shoqëruar nga Zëvendës-prokurori i Qarkut, Jovica Jovanovi dhe punëtorë të policisë kriminalistike. Para shtëpisë së Ahmetajve ndodhej grumbulli i trupave. Disa meshkuj jepnin shenja jete. Në prezencën e tridhjetë pjesëtarëve të Njësisë Speciale Antiterroriste, gjykatësja hetuese, Danica Marinkovi, haptazi kishte thënë: ‘unë këta nuk i marr me vete, vrisni!’ I vranë me Heckler. Rezultatet e hetimeve nga vendi ku ishte kryer krimi nuk u publikuan asnjëherë. Më 1 mars 1998, katërmbëdhjetë kufoma u transferuan në spitalin e Prishtinës.

Gjykatësja hetuese nuk dha urdhër që të bëhej autopsia, kështu që kufomat, pas identifikimit, iu dorëzuan familjeve. Pjesëtarët e policisë që kishin marrë pjesë në aksionin e Likoshanit tregojnë se pushkët dhe bombat ishin vendosur më vonë pranë trupave të të vrarëve dhe ky falsifikim shërbeu për informimin e opinionit shkruan Nataša Kandi.

“Epoka e re”: Supozoj se kjo hetuese veprimi njësoj edhe me ekzekutuesit e vrasjes së Fehmi Aganit.

Bardhyl Mahmuti: Sikurse edhe në rastet e tjera, qëndrimi i Danica Marinkovi ishte i njëjtë: faji ishte i shqiptarëve! Kjo gjykatëse i lroi policët serbë Predrag Nikoli dhe Zoran Dzeletovi, me arsyetimin se të akuzuarit “e kishin kryer punën e tyre ndershmërisht”. Se sa “ndershmërisht e kishin kryer punën e tyre” këta policë serbë, dëshmon Nataša Kandi. Në shkrimin e lartpërmendur (“E vërteta shqetësuese”) ajo tregoi se “të njëjtën ditë kur kishin vrarë Fehmi Aganin, më 6 maj 1999, në rrugën hekurudhore Lipjan - Fushë-Kosovë, të njëjtët policë i vranë edhe pesë anëtarë të familjes Blakqori: Miradijen (50 vjeç), Fehmiun (60 vjeç) Labinotin (14 vjeç), Mehmetin (56 vjeç) dhe gruan e tij, Sabilen (50 vjeç). Edhe për këto vrasje u ngrit kallëzim penal kundër Predrag Nikoliqit, Zoran Dzeletoviqit dhe një polici tjetër të Stacionit Policor të Fushë-Kosovës. Pastaj i tërë dokumentacioni u bart në Serbi ose u asgjësua.” Meqenëse vrasjet “ishin kryer ndershmërisht” dhe gjykatësja hetuese, Danica Marinkovi, e kishte “ndriçuar ndershmërisht” këtë krim, zyrtarët e lartë të Shërbimit Sekret Serb, në botimin e vitit 2003 të “Librit të bardhë” të titulluar “Albanski terorizmi i organizovani kriminal na Kosovu i Metohiji” (Terorizmi shqiptar dhe krimi i organizuar në Kosovë dhe Dukagjin), në faqen 22, vrasja e Fehmi Aganit i vishet UÇK-së!

edhe këto vrasje propaganda serbe ua veshi “terroristëve shqiptarë”! Me një dallim të vogël në renditjen e tyre në listën e “civilëve të vrarë nga UÇK-ja”: Në botimin e vitit 2000 të “Librit të bardhë”, Bajram Kelmendi dhe dy djemve të tij, Kastrioti dhe Kushtrimi, janë të renditur njëri pas tjetrit, në numrat rendor 237, 238 dhe 239, ndërkaq në botimin e vitit 2001 Bajram Kelmendi është në numrin 103, f. 45, kurse Kastrioti dhe Kushtrimi në numrin rendor 106 dhe 107 (f. 46).

103. КЕЉМЕНДИ БАЈРАМ, из Приштине, рођен 1933. године. Убијен 26.03.1999. године у Приштини у близини ауто-пијаче из аутоматског ватреног оружја, од стране албанских терориста, заједно са синовима Кастриотом и Куштримом (доказ: 83/00-990, 288/00-5).

106. КЕЉМЕНДИ КАСТРИОТ, из Приштине, рођен 1968. године, од оца Бајрама. Убијен 26.03.1999. у Приштини у близини ауто-пијаче из аутоматског ватреног оружја, од стране албанских терориста (доказ: 83/00-990, 288/00-5).

107. КЕЉМЕНДИ КУШТРИМ, из Приштине, рођен 1982. године, од оца Бајрама. Убијен 26.03.1999. у Приштини у близини ауто-пијаче из аутоматског ватреног оружја, од стране албанских терориста (доказ: 83/00-990, 288/00-5).

Në të njëjtën ditë kur u vra Bajram Kelmendi dhe djemtë e tij, në qytetin e Mitrovicës forcat serbe vranë profesorin e Universitetit të Prishtinës, Latif Berishën, që në atë kohë ishte kryetar i LDK-së për qytetin e Mitrovicës dhe Agim Hajrizin, cili ishte kryetar i Kuvendit të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

28. БЕРИША ЉАТИФ, из Косовске Митровице, Анке Спајић 35, рођен 1931. године. Убијен 24.03.1999. у К. Митровици испред своје куће, из аутоматског оружја, од стране албанских терориста (доказ: 83/00-989, 288/00-5).

Agim Hajrizi u vra së bashku me nënën e vet, Nazmijen, 60 vjeçe dhe me djalin, Ilirin, 12 vjeçe.

213. ХАЈРИЗИ АГИМ, из Косовске Митровице, ул. Цара Лазара 7, рођен 1959. године, убијен 24.03.1999. у К. Митровици, у породичној кући од стране албанских терориста из аутоматског оружја, заједно са мајком Назмијом и сином Иљиром (доказ: 83/00-988, 288/00-5).

214. ХАЈРИЗИ ИЉИР, из Косовске Митровице, ул. Цара Лазара 7, рођен 1987. године, од оца Агима, убијен 24.03.1999. у у породичној кући у К. Митровици из аутоматског оружја, од стране албанских терориста (доказ: 83/00-988, 288/00-5).

22

Më 24 mars 1999 forcat policore serbe hynë në shtëpinë e juristëve të njohur të Kosovës, Bajram dhe Nekibe Kelmendi. Fillimisht Bajrami dhe të dy djemtë e tij, Kushtrimi 18 vjeç dhe Kastrioti 31 vjeç, u keqtrajtuar përpara syve të grave dhe fëmijëve, pastaj kishin treguar “humanizmin” e tyre duke i thënë Kushtrimit “t’i puthte fëmijët e vet për t’u dhënë lamtumirën e fundit”! Ata u ekzekutuan, ndërkaq kufomat u gjetën më 26 mars 1999 në periferi të Prishtinës.

Qoftë gjatë kohës së pushtetit të Slobodan Millosheviqit, qoftë pas përmbyesjes së tij nga pushteti,

Në aspektin kohor vrasja e drejtuesit të Qendrës për Informim të Kosovës, Enver Malokut, kishte ndodhur më 11 janar 1999, pra përpara se të vriteshin personalitetet e lartpërmendura. E lash ta përmend pas tyre, për arsye se prezantimi i kësaj vrasjeje nga ana e Shërbimit Sekret të Serbisë dallon nga rastet e tjera.

215. ХАЈРИЗИ НАЗМИЈА, из Косовске Митровице, ул. Цара Лазара 7, рођена 1939. године. Убијена 24.03.1999. у породичној кући у К. Митровици из аутоматског оружја од стране албанских терориста заједно са сином Агимом и унуком Иљиром (доказ: 83/00-988, 288/00-5).

“Epoka e re”: Ku qëndron dallimi? **Bardhyl Mahmuti:** Pas fushatës fillestare për t’ia veshur UÇK-së vrasjen e këtij intelektual shqiptar, propaganda zyrtare e Serbisë u përpoq ta linte në heshtje vrasjen e Enver Malokut. Për dallim nga “sqarimet” shtesë që jepen për vrasjet e tjera në listën e “civilëve të vrarë” që i vishen UÇK-së, ku theksohet se “ishin vrarë nga terroristët shqiptarë”, në rastin e Enver Malokut nuk përmendet se kush e ka kryer vrasjen! Madje

39. МАЉОКУ ЕНВЕР, уредник Косовског информативног центар у фебруару 1999. године (доказ 328/00-8).

“Epoka e re”: Ju e përmendët edhe më parë se gjatë aktivitetit diplomatik në Parlamentin Evropian, ju shpërndatët edhe data e vrasjes është e rreme (shkurt 1999)!

39. МАЉОКУ ЕНВЕР, уредник Косовског информативног центар у фебруару 1999. године (доказ 328/00-8).

“Epoka e re”: Ju e përmendët edhe më parë se gjatë aktivitetit diplomatik në Parlamentin Evropian, ju shpërndatët

materialin e përpiluar mbi bazën e të dhënave që kishte publikuar Qendra për Informim të Kosovës

(QIK), e udhëhequr nga Enver Maloku. Si e pritët vrasjen e tij?

Bardhyl Mahmuti: Vrasja e Enver Malokut katër ditë përpara se të ndodhte masakra në fshatin Reçak ishte një goditje shumë e rëndë për rezistencën tonë kombëtare dhe paralajmërim se ishim duke hyrë në fazën përfundimtare të zbatimit të genocidit në Kosovë. Sipas planit që e pamë të realizohej pas këtyre krimeve, regjimi i Millosheviqit kishte përgatitur ta shndërronte Kosovën në “teatër me dyer të mbyllura”, ku tragjedia e popullit shqiptar duhej të luhej pa dëshmitarë, për ta shmangur mundësinë e informimit të opinionit publik ndërkombëtar. Në funksion të kësaj strategjie, Shërbimi Sekret i

Serbisë kreu vrasjen e Enver Malokut, drejtuesit dhe shtyllës kurrizore të QIK-ut. Për vrasjen e Enver Malokut mbajtëm dy konferenca me gazetarë: Adem Demaçi në Prishtinë, ndërkaq unë në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Në të dy konferencat denoncua publikisht këtë krim dhe pa asnjë ngurrim bëmë përgjegjës Shërbimin Sekret të Serbisë!

“Epoka e re”: Më kujtohet se gazetarët që raportuan nga konferenca juaj në Selinë e OKB-së në Gjenevë përmendën se gazetari rus kishte kërkuar nga ju t’i jepnit fakte që do të dëshmonin se prapa kësaj vrasjeje qëndronin Shërbimet Sekrete të Serbisë.

Bardhyl Mahmuti: Në pamundësi të pjesëmarrjes së gazetarëve serbë në konferencat e organizuara me gazetarët e akredituar në Selinë e OKB-së në Gjenevë, Serbia përpiqej t’i përcillte mesazhet e veta nëpërmjet gazetarit të agjencisë ruse ITAR-TASS. Mirëpo për gazetarët e agjencive të tjera ishte e qartë se në interes të kujt shkonte vrasja e kokës së Qendrës

Informative të Kosovës. Jo vetëm gazetarë rusë, por ka pasur edhe gazetarë shqiptarë apo veprimtarë politikë të LDK-së që kanë drejtuar gishtin në adresë të gabuar, dhe me vetëdije apo pa vetëdije, kanë çuar ujë në mullirin e gënjeshtrove serbe që bluatin “miellin” për kulaçet e gatuar në kuzhinën e Shërbimit Sekret të Serbisë!

“Epoka e re”: Kemi dëgjuar edhe në Kuvendin e Kosovës akuza drejtuar Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK) për vrasjen e Enver Malokut.

Bardhyl Mahmuti: Fatkeqësisht “kuleçtë” e propagandës serbe i kanë ngrënë edhe një numër i konsiderueshëm njerëzish të verbëruar nga rivalitetet partiake. SHIK-u nuk ka ekzistuar gjatë luftës çlirimtare dhe, rrjedhimisht, nuk ka ekzistuar as më 11 janar kur është vrarë Enver Maloku! Po e përsëris: Shtabi Strategjik i Millosheviqit kishte vendosur që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të ndërmerre sulme terroriste

kundër civilëve serbë, shqiptarë dhe të përkatësive të tjera etnike, të cilat duhej t’i visheshin UÇK-së. Sipas pohimeve të ish-shefit të Shërbimit Sekret, Radomir Markovi, numri i krimeve të kësaj natyre ishte aq i madh sa po të publikohej lista e tyre do ta rrezonte Serbinë në gjunjë!

Jam plotësisht i vetëdijshëm se edhe sot e kësaj dite bashkëpunëtorët e Serbisë, dhe pjella e tyre, vazhdojnë t’i zbatojnë udhëzimet e Shtabi Strategjik të Millosheviqit dhe për këto krime ta fajësojnë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës! Mirëpo më vjen keq për ata që nuk ka asnjë lidhje me shërbimet, por që mjerisht kanë rënë viktimë e propagandës së atij shtabi dhe vazhdojnë të përhapin gënjeshtret e sajua me qëllim të njollosjes së luftës sonë çlirimtare.

“Epoka e re”: Pas përfundimit të luftës është përfolur se në vrasjen e Enver Malokut ka qenë i përfshirë edhe inspektori i lartë i Sigurimit Shtetëror të Serbisë, i përkatësisë etnike shqiptare, Lutfi Ajazi.

Bardhyl Mahmuti: Po! Për të është thënë se ka qenë i përfshirë edhe në vrasje dhe krime të tjera. Madje, me sa më kujtohet, është thënë se ky kriminel ka marrë pjesë edhe në tentimvrasjen e njërit nga themeluesit e LDK-së, intelektualit Sabri Hamiti, më 24 shtator 1998. Fatmirësisht Sabri Hamiti u shpëtoi plagëve që kishte marrë në atentatin kundër tij.

Nuk mund ta di saktësisht në cilat krime kanë qenë të përfshirë drejtpërsëdrejti Selim Broshaj, Ibush Kllokoqi, Lutfi Ajazi, Ajat Istogu, Jakup Hoti, Nazim Bllaca dhe bashkëpunëtorët e tjerë të okupatorëve serbë me origjinë shqiptare, por mund ta them me bindje të plotë se asnjë vrasje e kësaj natyre nuk është bërë me urdhër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Personalitete të larta politike që kanë pasur funksione të larta shtetërore e pohojnë publikisht se urdhërdhënës për kryerjen e këtyre krimeve ka qenë Shtabi Strategjik i Sllobodan Millosheviqit, zbatues i urdhrit ka qenë Shërbimi Sekret i Serbisë, ndërsa ekzekutues kanë qenë kriminelë të përkatësive të ndryshme etnike.

(Muhamet Mavraj / Vijon)

NUMRI 598 Viti III
e prente 15 janar 1999
Çmimi 2 din, 15 den

faqe 6
Janusz Bugajski
Buzë p
së luft
Gjendja në terren mbetet
në një kaos ekonomik, luf
shpërberje territoriale, at
kalimtare” rëndësi për të

Perfaqësuesi politik i UÇK-së në Zvicër për lirin e tetë ushtarëve “jugosllavë”
faqe 3
**Bardhyl Mahmuti: Beogradi
i ka 10 ditë për lirin e
nëntë ushtarëve shqiptarë**

“Në qoftë se nuk lirohen, personat të cilët
përfaqësojnë bashkësinë ndërkombëtare
nuk do të mund të vijnë më tek ne dhe të
kërkojnë nga ne ndonjë gjë...”
I pyetur se si e komenton vrasjen e shefit
të QIK-ut, Enver Maloku, z. Mahmuti para
gazetarëve në Gjenevë deklaroi se pas
këtij atentati të paskrupullit qëndrojnë
shërbimet sekrete serbe

Avokati i Veselit dhe Thaçit kundërshtojnë dokumentet e paraqitura në Speciale: Prokuroria u shërbye me prova nga shërbimi sekret i Serbisë

HAGË, 30 TETOR - Avokati i ish-kryeparlamentarit të Kosovës, Kadri Veselit, Ben Emmerson, gjatë prezantimit të një dokumenti gjatë dëshmisë së njërit dëshmitar të hënën, ka deklaruar se është dokument i dhënë nga autoritetet serbe.

Emmersoni ka thënë se kjo provë si e tillë duhet kundërshtuar nga mbrojtja dhe duhet të identifikohet për vërtetësinë e saj. "Pra, ndër provat materiale shoqëruese, që lidhen me shënim përgatitor, është një dokument që i është treguar dëshmitarit gjatë seancës përgatitore, që është një dokument qartazi i dhënë nga autoritetet serbe ndonëse ju keni dhe originalin edhe përkthimin në anglisht. Por, është pjesë e së njëjtës kategori me dokumentet që kemi kundërshtuar sa iu takon të dhënave që janë futur nga shërbimi sekret serb përpara se të jepej dëshmia në TPNJ, në ish-Tribunalin e Hagës. Dhe sikurse e dini, një nga këto dokumente është shënuar për identifikim sepse duhet diskutuar ende mes palëve



dhe duhet të dalim me parashtrimet konkrete", ka pohuar Emmerson.

Ai ka shtuar se sa i takon dokumentit tjetër, është një dokument që është pranuar,

megjithatë është edhe ky dokument që është objekt debati gjyqësor. "Ne kemi kërkuar që Trupi Gjyqësor që ta riklasifikojë sepse edhe ky është i shënuar për identifikim", ka deklaruar

Emmerson, raporton "Albanian Post". Ai ka theksuar se po në atë material ka edhe shënime të cilat tregojnë se janë dhënë nga shërbimi sekret serb. Edhe avokati i ish-presidentit të

Kosovës, Hashim Thaçit, Gregory Kehoe, ka kundërshtuar dokumentet të cilat janë paraqitur në Speciale. Sipas tij, të njëjtat nuk janë paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. "Ne parashtrijmë që këto dokumente nuk janë paraqitur nga ZPS-ja ashtu siç thuhet", ka deklaruar Kehoe.

Edhe më 9 nëntor, derisa po përfundonte seanca e së hënës në Gjykatën Speciale, ku po dëshmonte ish-gazetari i mediumit serb "Tanjug", Nebojsa Radosheviç, avokati i Kadri Veselit, Ben Emmerson, ka ngritur një rast që, nëse vërtetohet, përbën një nga skandalet më të mëdha prejse ka filluar seancat Specialja. Emmersoni tregoi se në shënime përgatitore për dëshmitarin e radhës është vërejtur se ai ka tentuar të negociojë me Prokurorinë një pako përfitimi për të në këmbim të dëshmisë. Avokati, po ashtu, kishte thënë se vërehet se aty dallohet një zyrtar i prokurorisë teksa i sugjeron dëshmitarit mundësi përfitimi në këmbim të dëshmisë.

Specialja bastis shtëpitë e ish-këshilltarëve të Thaçit, reagojnë KMDLNj-ja dhe OVLUÇK-ja

PRISHTINË, 30 TETOR - Një bastisje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ka ndodhur të hënën në mëngjes në banesën e Blerim Shalës, ish-këshilltar politik i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili po gjykohej nga Dhoma e Specializuar të Kosovës për krime të pretenduara luftime në Hagë të Holandës.

I njëjti aksion është kryer edhe në shtëpinë e ish-drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Bashkim Smaka, i cili për një kohë ka shërbyer në ekipin këshillëdhënës të ish-presidentit Thaçi.

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka njoftuar se në këto aksione është asistuar nga Policia e Kosovës dhe Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) gjatë këtyre operacioneve.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) në një reagim ka theksuar se "Gjykata Speciale e Kosovës, të cilën e quan Gjykata Raciste Speciale, si burim të informatave për të sajuar dëshmi, në masën 80 % mbështetet në burimet serbe qoftë nga institucionet hetuese, zbuluese, kundërzbuluese apo të prokurorisë serbe sikur edhe mediet nga Serbia, OJQ-ve, gjithashtu nga Serbia, ndërkaq 20 % i sigurojnë në Kosovë (nga partitë politike, institucionet shtetërore, disa media, analistë të korrumpuar sikur edhe nga familjarët që kërkojnë informata për anëtarët e

tyre të zhdukur apo të vvarë gjatë luftës së fundit dhe pas përfundimit të luftës nga persona të paidentifikuar".

KMDLNj ka theksuar se pas bastisjeve të banesës së Blerim Shalës dhe Bashkim Smakaj hetues inkursorë të Gjykatës Raciste Speciale konfiskuan telefona, pajisje të tjera elektronike dhe materiale të ndryshme të shkruara apo të filmuara. "Nga krejt këto bastisje është fakt se sjellja e hetuesve nuk është e dhunshme (fizikisht), nuk ka shkatërrime materiale, bëhen në prani të avokatit që autorizohet nga pala që bastiset dhe, sidomos kohëve të fundit fëmijët e moshës jomadhore largohen nga objekti që bastiset. Realisht, mund të flasim për një dhunë psikologjike dhe pasiguri të shkaktuar për shkak të bastisjeve të paparalajmëruara dhe mbajtja nën presion të personave të bastisur për një kohë të gjatë deri në një vendim të gjykatës. Në këtë mënyrë po shënjestërohen të gjithë ata që në një mënyrë apo tjetër po e kundërshtojnë këtë gjykatë sikur edhe ata që kanë qenë në marrëdhënie të punës të udhëheqësit e UÇK-së dhe të institucioneve shtetërore të Kosovës, në çfarëdo cilësie. Gjithashtu, po shënjestërohen edhe ata që falë postit në të kaluarën e tyre kanë qenë në vende ku ka pasur informata të ndjeshme të cilat GjRS, nën kërcënim për ndjekje penale po mundohet t'i sigurojë nga këta persona të cilët



nuk kanë asnjë detyrim të bashkëpunojnë me ZPS-së", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që me urgjencë të trajtojnë këtë dukuri dhe shpërfilljen që ia bënë kjo gjykatë shtetit të Kosovës në përgjithësi dhe Kuvendit të Kosovës si themelues i kësaj gjykate në veçanti.

Artan Behrami, ish-këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, i ka quajtur skandaloze dhe të paprecedentë bastisjen e shtëpisë së Blerim Shalës dhe Bashkim Smakaj nga Gjykata Speciale në. "Gjykata Speciale është fashiste, sepse përndjek, arreston dhe dënon vetëm shqiptarët. Prokuroria është në panik! Po

humb çdo betejë juridike! Ndërsa gjykata, në përpjekje për ta ndihmuar prokurorinë, seancat tragjike-komike po mundohet t'i mbulojë me spektakle. Bastisja e shtëpive të kolegëve, Blerimit dhe Bashkimit, është skandaloze dhe e paprecedent!", ka shkruar Behrami në "Facebook".

Ai ka thënë se kjo qasje e prokurorisë është një dëshmi e qartë se ka një tendencë për t'i njollësuar të gjithë shqiptarët që kanë dhënë kontribut për liri dhe shtetndërtim. "Unë dhe kolegët e mi që kemi pasur nderin të bashkëpunojmë me presidentin Thaçi nuk frikësohemi nga trokitjet e kësaj prokurorie në dyert e shtëpive tona. Ata nuk kanë policë për t'i bastisur të gjithë

shqiptarët, ata nuk kanë prokurorë për t'i akuzuar të gjithë shqiptarët, ata nuk kanë burgje për t'i mbajtur të gjithë shqiptarët, që mbrojnë luftën çlirimtare të Kosovës!", ka shkruar Behrami.

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL- UÇK), Faton Klinaku, i ka quajtur "spektakël" bastisjet e Gjykatës Speciale të cilat janë duke u kryer në vendbanimin e Blerim Shalës dhe Bashkim Smakës.

Përmes një shkrimi në rrjetin social "Facebook", Klinaku ka thënë se këto janë spektakli i radhës me arsyetimin se po bëjnë diçka. "Bastisjet e Speciales, spektakël i radhës. Kinse po bëjmë e po gjejmë diçka", ka shkruar ai.

Lajçaku: Nuk është vetëm Asociacioni, edhe Serbia ka obligime të pazbatuara

PRISHTINË, 30 TETOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, nënvizoi domosdoshmërinë që, përveç Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që është obligim i Kosovës, Serbia duhet t'i zbatojë të gjitha nenet e Marrëveshjes për rrugën drejt normalizimit të raporteve. "Por, ky [Asociacioni] nuk është i vetmi element që duhet të zbatohet. Serbia, po ashtu, ka shumë obligime të pazbatuara nga Marrëveshja dhe ne duhet të shohim që zbatimi të ecë paralelisht, në mënyrë që Kosova dhe Serbia të marrin atë për të cilën janë pajtuar", tha Lajçaku përmes një postimi në rrjetet sociale.

Duke i referuar propozimit të fundit evropian për statutin për Asociacionin, që iu paraqit palëve më 21 tetor gjatë vizitës së "Pesëshes së Madhe", Lajçaku theksoi se ky propozim është një mënyrë moderne evropiane për zgjidhjen e çështjes së ndjeshme të mbrojtjes së pakicave në përputhje me standardet më të mira evropiane "dhe nuk shkel

vijat e kuqe të paraqitura nga palët".

Lajçaku konfirmoi se Kosova dhe Serbia kanë pasur komente dhe pyetje lidhur me propozimin evropian dhe tha se blloku evropian në javët në vijim do t'i sqarojë të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e palëve. Ai paralajmëroi një takim midis kryenegociatorëve të Kosovës dhe Serbisë për të diskutuar hapat e ardhshëm në zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit. "Tani fokusi duhet të jetë në avancimin e zbatimit të marrëveshjes pa parakushte dhe vonesa. Siç e kanë theksuar qartë liderët evropianë, formalitetet nuk duhet të pengojnë këtë proces të rëndësishëm", shkroi emisari evropian.

Më 26 tetor liderët e tri shteteve kyçe të BE-së - Francës, Gjermanisë dhe Italisë - së bashku me përfaqësuesit e institucioneve të bllokut, zhvilluan takime të ndara me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Pavarësisht prej përfshirjes së



nivelit të lartë politik në përpjekjet për ta zhbllokuar dialogun, palët nuk arritën të pajtoheshin për çështjen e zbatimit të marrëveshjeve të arritura më herët.

Kurti shprehu gatishmërinë që të nënshkruajë një Marrëveshje për normalizim, përfshirë edhe propozimin evropian për formimin e Asociacionit, por shtoi se Vuçiqi nuk ishte i gatshëm. Vuçiqi ka thënë se është i gatshëm t'i zbatojë nenet e Marrëveshjes

drejt normalizimit që nuk përfshijnë respektimin e integritetit territorial të Kosovës dhe anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara.

Më 27 shkurt Kurti dhe Vuçiqi arritën Marrëveshjen drejt normalizimit. Më 18 mars në Ohër palët u pajtuan për Aneksin e zbatimit të marrëveshjes. Megjithatë, marrëveshja nuk është nënshkruar nga palët, pasi presidenti serb ka refuzuar duke argumentuar se "Serbia është

shtet i njohur ndërkombëtarisht, ndërsa Kosova jo".

Kjo marrëveshje, prej 11 nenes, mes të tjerash, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut.

Një ditë pas takimeve në Bruksel, Franca, Gjermania dhe Italia i kërkuan Serbisë që ta njohë de facto Kosovën dhe që Kosova ta formojë Asociacionin.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Kosova deri më tani ka refuzuar ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke shprehur frikën se mund ta cenojë funksionalitetin e shtetit. Serbia, ndërkaq, insiston në themelimin e tij.

Kurti do të raportojë në Kuvend rreth propozimit për Asociacionin

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 TETOR - Me kërkesë të partive opozitare, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 3 nëntor do të raportojë para Kuvendit të Kosovës për dialogun me Serbinë, veçmas për draft-statutin e propozuar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare të subjekteve opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, thanë se Kurti e ka obligim ligjor të raportojë pas takimeve që ka zhvilluar në Bruksel më 26 tetor me krerët e Francës, të Gjermanisë, të Italisë dhe me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian.

Pas takimeve të ndara të Kurtit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me liderët evropianë, kryeministri i Kosovës tha se ka pranuar propozimin për Asociacionin dhe ka qenë i gatshëm të nënshkruajë marrëveshje për normalizim të raporteve, por kjo është kundërshtuar nga lideri serb.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, tha se gjatë raportimit, Kurti duhet të njoftojë se për çfarë saktësisht është pajtuar dhe si do të dukej një Asociacion në bazë të propozimit evropian. "Është shumë e rëndësishme që ta kuptojnë qytetarët dhe ne si përfaqësues të qytetarëve se për çfarë është



pajtuar Qeveria e Kosovës, në këtë rast përmes kryeministrit, në cilat pika dhe si do të jetë ai lloj Asociacioni", tha ai.

Kurti ka deklaruar se drafti i propozuar për Asociacionin është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Dokumenti nuk është bërë publik, me kërkesë të ndërmjetësuesve ndërkombëtarë. Shefi i deputetëve të LDK-së, Arben Gashi, tha se në të kaluarën ka pasur kërkesa të tilla për mospublikimin e dokumenteve, por ai tha se pret që Kurti të vijë në Kuvend së bashku me dokumentin për Asociacionin të cilin e ka pranuar. "Gjithmonë nga ndërmjetësuesit janë bërë të njëjtat kërkesa. Por, në kohë të

mëhershme, kur negociuesit dhe bashkëbiseduesit nuk kanë bërë publike dokumentet, kryeministri i Kosovës i ka cilësuar si tradhti dhe tendencë për të fshehur akte të tradhtisë. Pra, nuk e dimë se çfarë ka në ato dokumente. Për ne është me rëndësi që në ato dokumente të kemi qasje si Kuvend i Republikës së Kosovës", tha Gashi. Propozimi që, sipas BE-së, është një model evropian për statutin e Asociacionit, u është paraqitur Kosovës dhe Serbisë gjatë vizitës më 21 tetor në këto dy shtete të përfaqësuesve të BE-së, Shteteve të Bashkuara, Francës, Gjermanisë dhe Italisë.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së tha se raportimi i Kurtit për këtë

çështje "është i rëndësishëm jo vetëm sa i përket transparencës, por edhe për t'i dhënë llogari Kuvendit".

Përderisa përfaqësuesit e partive opozitare thanë se nuk e kanë parë dokumentin e paraqitur nga ndërkombëtarët, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, Mimoza Kusari-Lila, tha se është në dijeni me përmbajtjen e draftit. "Ne si grup parlamentar jemi të informuar për përmbajtjen e draftit të parë, përkatësisht pikave kryesore që janë në përputhje me Kushtetutën, por gjithashtu [që ky dokument] nuk është versioni final. Do të thotë, kjo është një punë në proces. Nuk kemi të

bëjmë me diçka të finalizuar ende. Ju e dini që nuk ka pasur nënshkrim të marrëveshjes në Bruksel", tha Kusari-Lila.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij.

Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Kosova deri më tani ka refuzuar ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke shprehur frikën se mund ta cenojë funksionalitetin e shtetit. Serbia, ndërkaq, insiston në themelimin e tij.

I dërguari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se draft-statuti për Asociacionin nuk shkel "vijat e kuqe" të palëve, duke shtuar se ky nuk është elementi i vetëm që duhet të zbatohet, pasi që Serbia nuk ka zbatuar nene të Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve.

Këtë marrëveshje Kosova dhe Serbia e arritën më herët gjatë vitit. Marrëveshja, prej 11 nenes, mes të tjerash, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut.

Një ditë pas takimeve në Bruksel, Franca, Gjermania dhe Italia i kërkuan Serbisë ta njohë de facto Kosovën dhe që Kosova ta formojë Asociacionin.

Punëtorët fizikë të KEK-ut më 13 nëntor hyjnë në grevë

PRISHTINË, 30 TETOR - Shoqata Sindikale "Siguria Fizike" në KEK kanë protestuar të hënën para zyrave të kësaj korporate në Prishtinë. Ata kanë kërkuar kthimin si punëtorë të KEK-ut dhe jo të tenderohen vazhdimisht, siç thanë, jashtëligjshëm në sektorin privat.

Kryetari i kësaj shoqate, Nexhat Murati, ka thënë se kërkojnë një takim urgjent me menaxhmentin e KEK-ut për të mos hyrë në grevë më 13 të këtij

muaji. "Ne i kërkojmë KEK-ut një takim urgjent për të na dhënë një mundësi që mos të futemi në grevë nga data 13 e këtij muaji. Ne po kërkojmë drejtësi. Kemi marrë vesh që KEK-u po shpall tenderë në mënyrë të paligjshme. Ne nuk kemi rrugëdalje tjetër përpos grevës që do ta mbajmë pikërisht këtu me një tendë që e kemi marrë lejen nga komuna dhe Policia e Kosovës", ka thënë Murati.

Kryetari i Sindikatës së Re të

KEK-ut, Nexhat Llumnica, ka thënë se në KEK është bërë një tender i jashtëligjshëm. "Arsyeja e kësaj proteste të shpejtë është, sepse ky departament është huazuar në vitin 2004 dhe në vitin 2007 që është dashur të kthehet në KEK. Është bërë një tender i jashtëligjshëm. Këta punëtorë kanë paga shumë të ulëta dhe sigurimi i KEK-ut nuk mund të jetë një siguri i mirë ashtu siç mund të jetë brenda kompanisë së KEK-ut", ka thënë ai.



Një metër dru 65 euro

PRISHTINË, 30 TETOR - Me ftohjen e motit, qytetarët duhet të gjejnë mënyra për ngrohje me anë të druve, peletit ose rrymës. Por, çmimi i lartë i druve edhe këtë vit po u kushton shtrenjtë qytetarëve. Ata i thanë Radio Kosovës se çmimet e druve janë tejet të larta në krahasim me vitet e kaluara, kurse druvarët thonë se këtë vit çmimi i druve është më i ulët. Mentor Krasniqi nga Prishtina po kërkon të gjejë dru me çmim sa më të ulët. Çmimi i metrit të druve për Krasniqin është i lartë, por thotë se nuk ka zgjidhje tjetër. Ai thotë për "Radio Kosovën" se është detyruar të blejë dru për ngrohje për shkak të çmimit të lartë të rrymës. "Erdha të blej dru. Çmimi për metër është 65 euro. Vjet kanë qenë edhe më shtrenjtë. Edhe sivjet çmimi është i lartë, por

ngrohja me rrymë po na kushton më shumë, prandaj po duhet të blejmë dru. Janë pak shtrenjtë për ata që nuk kanë, por s'kemi çka të bëjmë. Po duhet të ballafaqohemi e të gjejmë zgjidhje. Gjatë dimrit po na shkojnë 6 deri 7 metra dru", ka thënë Krasniqi.

Edhe disa qytetarë të tjerë thanë se ngrohja me dru po u kushton edhe më shtrenjtë.

Njëri nga druvarët në Prishtinë, në kushte anonimiteti, ka thënë për "Radio Kosovën" se çmimi i një metri dru të llojit bung aktualisht tregtohet me çmim prej 65 eurosh. Sipas tij, vitin e kaluar çmimi i druve ishte më i lartë. Por, çmimet e druve për ngrohje në Kosovë gjatë dy viteve të fundit janë rritur dukshëm. Një metër kub dru, në të njëjtën periudhë të vitit 2021, kushtonte rreth 40 euro.



Konfiskohen mbi 440 kilogramë duhan në vlerë 7 000 euro



PRISHTINË, 30 TETOR - Policia e Kosovës gjatë 24 orëve të kaluara ka realizuar disa operacione policore në funksion të parandalimit të kontrabandës së mallrave dhe kalimit të paautorizuar të kufirit shtetëror. "Me datë 29.10.2023, rreth orës 09:10, në fshatin Mjak, policia kufitare, konkretisht Njësi Task Forcë-Lindja, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, gjatë realizimit të detyrave të vëzhgimit, kanë vërejtur një automjet duke hyrë nga territori i Republikës së Maqedonisë-veri në territorin e Republikës së Kosovës. Automjeti i tipit 'Renault' është ndaluar nga policia dhe gjatë kontrollit është gjetur sasi e kontrabanduar e mallit (duhan) si në vijim: duhan i papërpunuar 8 thasë me nga 10

kg, duhan i llojit Marlboro 250 pako x 0.5 kg, duhan i llojit Sobrani 250 pako x 0.5 kg, duhan i llojit Oriental 75 pako x 0.5 kg, duhan i llojit Davidov 225 pako x 0.5 kg, duhan i llojit Slims 25 pako x 0.5 kg, dhe duhan i llojit Virginia 100 pako x 0.5 kg. Sipas vlerësimeve fillestare nga kompetentët mbi 440 kilogram duhan sa janë sekuestruar kap vlerën e tregut rreth 7 mijë euro dhe rreth 19 mijë euro shmangie nga akciza", thuhet në njoftimin e policisë. Sipas njoftimit, një person i dyshuar është intervistuar dhe me urdhër të prokurorit është iniciuar rasti në procedurë të rregullt për "kontrabandë të mallrave", përderisa malli i kontrabanduar është dërguar në doganë për procedurë të mëtejme ligjore.

Menaxhmenti i "Trepçës" suspendon kryetarin e sindikatës Ibrahim Jonuzi dhe disa të tjerë


PRISHTINË, 30 TETOR - Menaxhmenti i "Trepçës" ka marrë vendim t'i suspendojë nga puna kryetarin e sindikatës, Ibrahim Jonuzin, nënkryetarin e sindikatës, dy anëtarë dhe një minator. Vendimi u është komunikuar

përmes telefonit. "Punonjësit Ibrahim Jonuzi, Fevzi Ademi, Desat Kerleshi, Eset Meha, punëtorë të 'Trepça Sh. A.', largohen përkohësisht nga puna, duke filluar nga data 27.10.2023", thuhet në vendimin e menaxhmentit

që është marrë para tri ditësh. Sindikata ka bërë me dije për "RTV Dukagjinin" se nuk u është thënë arsyeja e suspendimit dhe ende nuk kanë marrë një vendim zyrtar.



Timothy Garton Ash, në Tiranë për të rrëfyer historinë e të tashmes



Shkrimtari Timothy Garton Ash ka qenë në Tiranë këtë të hënë, për të prezantuar librin e tij "Homelands" ("Vendet e mia" – Botimet Dudaj).

Timothy Garton Ash është autor i 11 librave, të cilët siç thotë vetë, fokusin e kanë mbi transformimin e Evropës gjatë gjysmëshekullit të fundit. Ai është profesor i Sutimeve Evropiane në Universitetin e Oksfordit, studiues dhe bashkëpunëtor në Institutin Hoover, Universiteti i Stanfordit dhe gjithashtu analist i rregullt i çështjeve ndërkombëtare në të përditshmen britanike, "The Guardian".

Garton Ash, siç e theksoi Remzi Lani, drejtor i Institutit të Medias, në prezantimin e librit, është një shkrimtar që merret kryesisht me historinë e të tashmes. Dhe këtë ka bërë dhe në bashkëbisedimin në aktivitetin e organizuar me këtë

rast, ku të pranishëm kanë qenë ish presidentë, ministra e ish ministra, pjesëtarë të botës akademike, medias etj.

Libri i fundit i Timothy Garton Ash është përkthyer tashmë në 19 gjuhë të ndryshme.

E veçanta e autorit është se ai ka qenë dëshmitar i dorës së parë, në shumë prej vendeve dhe ngjarjeve që përmend në libër.

Si për shembull, atëherë në 1978-ën e largët, në takimin e tij të parë me Tiranën, i cili padyshim nuk do të kish qenë i mundur nëse nuk do të kishte pranuar të shkurtonte flokët e gjatë dhe barsetat në aeroportin e Rinasit, ku mbërriti bashkë me një grup profesorësh marksistë dhe kolegësh.

Apo atëherë kur, pak orë pas shembjes së Murit të Berlinit, tek shkelte disa metra brenda territorit dikur të ndaluar për perëndimorët, takonte një djalosh

që nuk e mbante dot gëzimin, i cili i tha: "Tani po, që ka përfunduar me të vërtetë Lufta".

Apo kur, menjëherë pas ribashkimit të dy Gjermanive, takoi kancelarin Helmut Kohl, "atë burrë gjigand, të gjatë e të gjerë si akush tjetër që ka takuar ndonjëherë", i cili me tonin e tij të rëndë të zërit iu drejtua: "A e di ti, që je duke takuar pasardhësin e drejtpërdrejtë të Adolf Hitlerit"? (E pasaktë kjo, sipas vetë Garton Ash, por që aq shumë ishte shastisur nga sjellja e Kancelarit, sa nuk kish mundur t'ia vinte në pah pasaktësinë e pohimit).

Mes shumë episodeve të tilla, tejet domethënëse, të cilat syri dhe mendja e mprehtë e shkrimtarit nuk ia ka dorëzuar harresës, falë edhe "shoqëruesve të pandarë", lapsit dhe bllokut në xhepin e brendshëm të xhakëtës, spikat padyshim ai i takimit me një rus, i

cili në bisedë e sipër i kishte thënë: "Krimea është e Rusisë". Një bisedë kjo, e bërë shumë vite përpara se të vinte 2014. "Besoj se e merrni vetë me mend", na tha vetë shkrimtari, se cili kishte qenë bashkëbiseduesi. (E morët me mend!) Vladimir Putin!

Duke ardhur më pranë, tek Shqipëria, një vend që e sheh pabesueshmërisht të transformuar pas vizitave në 1978 dhe 1991, ngadalësinë e procesit të integritimit evropian përpiket ta shpjegojë me një anekdotë historike. Duke sjellë në vëmendje qasjen e palëve të interesuara për problemin e rajonit të Alsaice-Lorraine, midis Francës dhe Gjermanisë: "Le ta mendojmë çdo ditë, por të mos flasim për të". Në rastin e Bashkimit Evropian dhe procesit të zgjerimit të tij në dekadat e fundit, sipas Timothy Garton Ash, qasja ka qenë e

përmbysur: "Le të flasim për të, por të mos e mendojmë".



Janë të gjitha copëza historish, ngjarjesh dhe bisedash që, të para "me mendtë pas kuvendit", ofrojnë shpjegime të kristalta për "historinë e të sotmes".

Çështja është, çfarë pritet të ndodhë?

Ku do të shkojë Evropa? Si do t'i përballojë ajo krizat? A do të jetë e ndarë, apo do të jetë e bashkuar, në një botë ku perëndimi, sipas vetë Garton Ash "nuk po dikton më agjendën"?

Edhe këtu, historia sipas shkrimtarit ka plot mësim për të dhënë.

Fjala vjen, çdo herë që Evropa ka patur një qasje Euroatlantiste, ajo ka qenë e bashkuar. Çdo herë që ka patur një qasje EuroGoliste, ka qenë e ndarë. Si do të shkojë? Historia e të tashmes me siguri do të na e tregojë.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova synon fitore ndaj Maqedonisë së Veriut

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave është gati për ndeshjen e radhës me Maqedoninë e Veriut në kuadër të Ligës së Kombeve e cila zhvillohet sot (e martë) nga ora 17:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". Futbollistet "dardane" e kanë zhvilluar të hënën stërvitjen e fundit para kësaj ndeshje shumë të rëndësishme. Futbollistja Lumbardha Misini ka thënë se pas fitores në ndeshjen e parë futbollistet "dardane" janë të motivuara për të arritur fitore edhe në ndeshjen e dytë ndaj Maqedonisë së Veriut. "Stërvitjet kanë shkuar shumë mirë. E kemi fituar ndeshjen e parë kundër Maqedonisë, tash e kemi ndeshjen e dytë që është shumë e rëndësishme. Ne jemi

munduar të përgatitemi sa më mirë dhe normalisht e duhet të qëndrojmë në këmbë në tokë dhe besojmë se do të nxjerrim një rezultat shumë të mirë. Nëse fitojmë edhe ndeshjen e dytë ndaj Maqedonisë do të kemi mundësinë që ta zhvillojmë finalen në stadiumin 'Fadil Vokrri' kundër Bullgarisë dhe të dalim liderë të grupit. Është hera e parë që mbahet një kompeticion i tillë për vajza dhe me një përkrahje nga tifozët 'dardane', familjarët dhe shikuesit e tjerë do të kishim një motiv më të madh për fitore", ka thënë ajo. Optimizëm për fitore ka shprehur edhe futbollistja tjetër e Kosovës, Blerta Smaili, e cila konfirmon se atmosfera është e mirë në kampion e "dardaneve" dhe se fitorja është opsioni i vetëm në stadiumin "Fadil Vokrri". "Normalisht se pas fitores jemi më pozitivë, përfshi edhe

atmosferën në ekip. Jemi maksimalisht të përgatitur dhe koncentruar për lojën që do nuk do të jetë aspak e lehtë. Tash na njohin kundërshtarët dhe duhet të japim më shumë se në lojën e parë dhe nëse i bëjmë këto gjërat që i kemi ushtruar deri tash, do të jemi shumë mirë. Qëllimi është të shkojmë më tutje dhe duhet të fitojmë në çdo ndeshje. Jemi të lumtur se mund të luajmë në 'Fadil Vokrri'. Shpresojmë se do të kemi sa më shumë shikues që të motivohemi për fitore", ka deklaruar Smaili. Për ndeshjen është demarkuar edhe përzgjedhja e Kosovës, Anneli Andersen, e cila ka deklaruar se Kosova pati paraqitje të mirë ndaj Maqedonisë së Veriut në udhëtim dhe gjatë këtyre ditëve përgatitjet janë bërë në mënyrën më të mirë të mundshme që një paraqitje të tillë ta bëjnë edhe si vendase.



Jep dorëheqje e tërë Kryesia e KF Deçani

DEÇAN, 30 TETOR - KF Deçani ka mbetur pa kryesi të klubit, pasi ka dhënë dorëheqje. Kryesia në fjalë e ka menaxhuar klubin për një vit e gjysmë. Kjo kryesi e ka marrë klubin në Ligën e Tretë "Rajoni i Dukagjinit - Grupi B" në vendin e 8 në tabelë. Pas një viti KF Deçani shpallet kampion dhe ngrehet në Ligën e Dytë. Tani pas 11 ndeshjeve të zhvilluara, KF Deçani nga 16 ekipet garuese pozicionohet në top pesëshen e Ligës së Dytë me gjithsej 19 pikë të fituara. "I falënderojmë të gjithë lojtarët dhe stafin për punën, mundin, sakrificën dhe gjithë suksesin e arritur me meritë. Falënderim dhe mirënjohje për komunën e Deçanit dhe të gjithë sponsorët që e ndihmuar klubin gjatë kësaj periudhe. Falënderim e mirënjohje nga zemra për tifozerinë më të mirë në Kosovë "Luftëtarët" të cilët ishin dhe do të jenë shpirti dhe lojtari i 12-



të i skuadrës. Urojmë që KF Deçani t'i arrijë të gjitha objektivat në të ardhmen

sepse e meriton. Mirupafshim", thuhet në njoftimin e lëshuar nga KF Deçani.

SHKURT

Albin Krasniqi mungon dy muaj

Mesfushori i FC Prishtina, Albin Krasniqi, ka pësuar një lëndim në ndeshjen e fundit ndaj SC Gjilanit dhe pritet të mungojë rreth dy muaj. "Albini ka pësuar frakturë në këmbën e djathtë dhe, pas ekzaminimeve të bëra, është konstatuar se do t'u mungojë fushave për rreth dy muaj. Me shpresën se do ta kalojë këtë periudhë me forcë dhe qetësi ashtu siç është në fushë, FC Prishtina, duke e qëndruar afër në çdo moment, i dëshiron shërim të shpejtë. Forca Albin, të presim më të fortë!", thuhet në njoftimin e Prishtinës. Skuadra e Prishtinës ka realizuar fitoren e parë pas shtatë ndeshjeve në Superligë dhe tash renditet në vendin e katërt me 16 pikë.

Zhegrova në formacionin e javës në Ligën 1

Edon Zhegrova ishte protagonist për Lillen në ndeshje ndaj Monacos (2-0). Anëtori nga Kosova asistoi në dy golat e vendësve, të cilat i shënuan Cavaliero e Diakite. Zhegrova u përfshi në ekipin ideal të xhiros së 10 në kampionatin francez. "WhoScored" e ka vlerësuar paraqitjen e Zhegrovës me notën 8,45, ndërsa e gjen veten në një ekip me Kylian Mbappen. "Një tjetër fitore, +2 asistime. Punë e madhe e ekipit. Falënderim për krejt tifozët. Ju jeni të mrekullueshëm", ka shkruar Zhegrova në "Instagram". Ekipi i javës: Lecomte, Diakite, Medina, Kouyate, Ismaily, Sotoca, Emery, Kanin, Zhegrova, Adams, Mbappe.

Qatip Osmani merr drejtimin e Vllaznisë së Shkodrës

Tekniku tetovar Qatip Osmani edhe zyrtarisht ka marrë drejtimin e skuadrës së Vllaznisë së Shkodrës. Zyrtarizimi i tij ka ardhur të hënën nga klubi shqiptar, me Osmanin që ka nisur menjëherë punën të Vllaznia, ndërsa për ndihmës do ta ketë Bashkim Livorekën. "Klubi i Futbollit Vllaznia dëshiron ta informojë opinionin publik se trajneri i ri i ekipit të parë të Vllaznisë do të jetë Qatip Osmani. Ai vjen te skuadra jonë pas një karriere të suksesshme te Shkëndija e Tetovës me të cilën ka fituar pesë trofe. Bashkë me të, në stafin e Vllaznisë do të jetë edhe Bashkim Ljivoreka që do ta ketë detyrën e zëvendëstrajnerit. Mirë se erdhët në familjen kuqeblu, profesor Qatipi dhe Bashkimi!", thuhet në njoftimin e Vllaznisë. Osmani e ka drejtuar Shkëndijën e Tetovës në periudha të ndryshme si dhe ka qenë trajner te Shkupi dhe Renova, ndërsa kjo do të jetë aventura e tij e parë në Shqipëri.

Neuer rikthehet pas 350 ditësh: Momenti më i lumtur në karrierën time

MUNCHEN, 30 TETOR - Manuel Neuerit iu desh të priste plot 350 ditë për ta veshur sërish fanellën e Bayern Munchenit në fushën e blertë. Takimi me Darmstadt koïncidoi i duhuri për 37-vjeçarin gjerman, të cilin e rrëmbyen emocionet

pas ndeshjes. "Momenti më i lumtur në karrierën time, pavarësisht çdo sukcesi të mëparshëm. Kam pritur kaq gjatë të jem aktiv dhe më në fund ia dola. Të luash përpara tifozëve të Bayernit është ndjesi vërtet speciale. Situata

ku u gjenda përballë Mehlemit ishte disi e vështirë, pasi mbrojtja e kishte humbur nga kontrollin. Fatmirësisht përfundoi pa dëme dhe ne e mbajtëm portën të pastër. Nuk e kam menduar kurrë tërheqjen, pavarësisht sa të

vështirë e pata shkallën e lëndimit. Vullneti i fortë dhe besimi më bënë të jem këtu. E di që aktualisht e kam humbur pozitën e mira për të nga trajneri Simone Inzaghi pas ndeshjes. "Asllani erdhi me një personalitet të madh. Po rritet shumë. Ka një vit e gjysmë këtu. E di që është ndryshe të luash tek Interi. Por ai po i gdhend minutat vetes sepse ai ka kualitet të madh dhe është një profesionist i madh. Jam shumë i lumtur me të", ka deklaruar Inzaghi.



Jalen Miller Blesa, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 30 TETOR - Futbollistit të FC Prishtina, Jalen Miller Blesa, i ka takuar çmimi "Ylli i javës" për javën e 11-të në Superligë që jepet nga Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall.

Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje: Muhamet Sylejmani, Ilmi Mehmeti dhe Rifat Nasufi. Ky komision vendosi që qendërsulmuesi i FC Prishtina, Jalen Miller Blesa, të shpallet më i miri i javës, pasi që qetësia që e karakterizoi gjatë tërë ndeshjes iu shpërblye me dy gola. E pikërisht golat e Blesas ua mundësuan bardhekalitërve të kryeqytetit fitoren në përballje me SC Gjilani në "Fadil Vokrri", me rezultat 2-1. Kjo ishte fitorja e tretë për FC Prishtina në këtë edicion, por e para pas shtatë ndeshjeve.

Pasi mori këtë çmim, sulmuesi amerikan u shpreh i lumtur që u



vlerësua kontributi i tij në këtë ndeshje tejet të rëndësishme për ta ruajtur hapin me skuadrat e kreut të tabelës. "Ndeshja shkoi shumë mirë. Jam shumë i lumtur për bashkëlojtarët e mi. Ne ndihmuam njëri-tjetrin shumë dhe dhamë 100%. Është trajneri i ri dhe strategjia e re. FC Prishtina

është një skuadër e madhe dhe ne presim të luajmë në Evropë. Strategjia e re dhe trajneri i ri po bëjnë që gjërat të ndryshojnë shumë shpejt, por gjithë ekipi do të adaptohet me kohë. Jam shumë i lumtur dhe emocionuar që u zgjodha ylli i javës", ka thënë Blesa për faqen zyrtare të FFK-së.

Kampionët e Denverit mposhtin Oklahoman

OKLAHOMA, 30 TETOR - Mbrëmje zhgënjyese kjo për dy nga ekipet "big" në NBA, Milwaukee e Lakersat, që humbën sfidat e radhës. Skuadra e Milwaukee u mund 127-110 në fushën e saj nga Atlanta, që korri fitoren e parë. Tetë lojtarë të Atlantës realizuan mbi 10 pikë, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Antetokounmpos.

Pas kohës shtesë humbet ekipi i lakersave, që u mund 132-127 nga Sacramento. Davisi me 30 pikë, Jamesi me 27 e Prince me 20 u përpoqën t'i japin fitoren ekipit



kalifornian, por pa sukses. Fox me 37 pikë e Monk me 22 pikë bënë dallimin për Kings. Vijnë marshimin ekipi i Denverit, që mundi me rezultat 128-95 Oklahoman, duke korrur fitoren e tretë radhazi. Sërish Jokiq,

protagonist, autor i 28 pikëve e 14 reboundeve. Clippersat, falë 21 pikëve të Leonardos, mundën me shifrat 123-83 San Antonion, ndërsa Golden State triumfoi me rezultat 106-95 ndaj Houstonit (Curry 24 pikë).

REZULTATET

Oklahoma - Denver	95-128
Houston - Golden State	95-106
Milwaukee - Atlanta	110-127
Philadelphia - Portland	126-98
Clippers - San Antonio	123-83
Sacramento - Lakers	132-127

SHKURT

Inzaghi: Asllani ka kualitet të madh

Skuadra e Interit e mposhti në derbin e Serisë A, Romën (1-0), falë golit të Thuram, i cili dërgoi në rrjetë një aksion që nisi nga këmbët e Kristjan Asllanit, i cili pasoi për Dimarcon dhe më pas ky i fundit për sulmuesin. Futbollisti shqiptar u inkuadrua në fushë në minutën e 75-të, në vendin e Çalhanoglu, teksa nuk munguan edhe fjalët e mira për të nga trajneri Simone Inzaghi pas ndeshjes. "Asllani erdhi me një personalitet të madh. Po rritet shumë. Ka një vit e gjysmë këtu. E di që është ndryshe të luash tek Interi. Por ai po i gdhend minutat vetes sepse ai ka kualitet të madh dhe është një profesionist i madh. Jam shumë i lumtur me të", ka deklaruar Inzaghi.

Xhaka: 8 fitore radhazi, kjo është ajo për çka po flas

Mesfushori shqiptar Granit Xhaka po kalon çaste të shkëlqyeshme me Bayer Leverkusenin në sezonin e tij të parë pasi u rikthye në Bundesligë pas përvojës pozitive që e pati në Angli me Arsenalin. Ylli nga Kosova është një prej lojtarëve kryesorë të ekipit të Xabi Alonsos. Leverkuseni e mposhti në fundjavë Freiburgun me rezultat 2-1 për të mbetur ekipi i vetëm i pamposhtur në këtë sezon në nëntë ndeshje të luajtura. Dhe Leverkuseni e arriti për herë të parë në histori serinë prej tetë fitoresh radhazi. "Tetë fitore radhazi. Kjo është ajo për çka jam duke folur. Faleminderit për mbështetjen e madhe!", ka shkruar Xhaka.

Keane: Fernandesit duhet t'i hiqet shiriti i kapitenit

Roy Keane, një element i rëndësishëm te Manchester Unitedi në epokën e Sir Alex Ferguson, beson se Bruno Fernandes nuk ka profilin e duhur për ta mbajtur shiritin e kapitenit, një pozicion që iu dha në fillim të sezonit nga Erik ten Hag. Trajneri holandez ia hoqi shiritin Harry Maguire dhe ia dorëzoi pikërisht mesfushorit portugez. "Pas asaj që pashë, të dielën do t'ia hiqja shiritin në krah. Bruno Fernandes nuk ka për të qenë kapiten. Ai është një futbollist brilant, nuk ka dyshime për këtë, por është krejtësisht e kundërta e asaj që i kërkohet një kapiteni te Manchester Unitedi. Këtë e kisha thënë disa herë sezonin e kaluar. Ishte një gabim... Ai vazhdimisht ankohet, bërtet, proteston me krahët në ajër. Nuk është e pranueshme dhe Ten Hag duhet ta marrë këtë vendim", ka thënë Keane.

Fury mendon për pensionim nga boksi

Boksieri Tyson Fury mund të pensionohet menjëherë dhe kjo nënkupton që ai nuk do të përballet me Oleksandr Usyk, siç ishte planifikuar më 23 dhjetor pas paraqitjes së zymtë të britanikut ndaj Ngannou të shtunën mbrëmë. Paraqitja e tij ndaj Ngannou ishte tejet e zbehtë, edhe pse në fund fitoi pas vendimit të gjyqtarëve. Siç raporton "Theworldboxingnews", 35-vjeçari mund të vendosë t'i japë fund karrierës së tij, gjë të cilën e ka theksuar edhe promotori i dueleve të mëdha të boksit Frank Warren i cili mësohet të ketë deklaruar se ai nuk do të luftojë ndaj Usyikut më 23 dhjetor.

Presidenti i Bayernit: Të gjithë e duan Musialan, por ai është i yni

"Nuk jemi të befashuar nga fakti që klube të tjera janë të interesuara për Musialan. Ai është një lojtar i jashtëzakonshëm dhe këtë gjë e ka treguar disa herë, përfshi ndeshjen e fundit në Ligën e

Kampionëve". Janë këto fjalët e presidentit të Bayern Munchenit, Herbert Hainer, që ka folur në lidhje me mundësinë e largimit të futbollistit 20-vjeçar. Musiala ka një kontratë deri në vitin 2026

me bavarezët dhe për momentin nuk duket se ka dëshirë ta rinovojë atë. Ndërkohë që klubi synon t'ia rinovojë atë edhe me një vit, për momentin bisedimet duken të vështira. Musiala ka tërhequr

vëmendjen e disa klubeve "big" në Evropë, si Real Madrid e Manchester City, ndërkohë që kostoja e kartonit të tij është rreth 100 milionë euro. "Ka një kontratë me ne deri në vitin 2026 dhe jemi të qetë në këtë

drejtim. Jamal e di atë që ka këtu te Bayerni dhe e di se këtu janë dyert e hapura për të. Do të kënaqesha nëse qëndron sa më gjatë këtu. Është ende shpejt për të biseduar për rinovimin", ka deklaruar Hainer.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.k, Prilep, K. Deçanë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 33.98MWp në Prilep, Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.12.2023 në ora 11:00 në Shkollën fillore "Sylejman Vokshi" kilometri i 5 – të, rruga Deçan – Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.k, Prilep, K. Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 33.98MWp në Prilep, Deçan.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Lokaj Solar" Sh.p.k, Prilep, K. Deçan, për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 33.98MWp në Prilep, Deçan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.k, Restavicë, K. Deçanë bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 15.44 MWp në Restavicë, Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.12.2023 në ora 10:00 në Shkollën fillore "Sylejman Vokshi" kilometri i 5 – të, rruga Deçan – Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.k, Restavicë, K. Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 15.44 MWp në Restavicë, Deçan.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Lokaj Solar" Sh.p.k, Prilep, K. Deçan, për Impiantin Fotovoltaik me kapacitet 15,44 MWp në Restavicë, Deçan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "AIM EDUCATION CENTER" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 812009331 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AIM EDUCATION CENTER" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 812009331 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "AIM EDUCATION CENTER" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812009331 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vjollca Juniku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Jeton Laskaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e lëshuar nga "Qendra për Aftësime Profesionale" drejtimi - Saldues.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801

